



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 35
Prishtinë, më 17.12.2018, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Glauk Konjufca, Fitore Pacolli, Doruntinë Maloku-Kastrati, Elmi Reçica, Evgjëni Thaçi-Dragusha dhe Zafir Berisha.

Munguan: Dukagjin Gorani dhe Srgjan Mitrovic.

Pjesëmarrës të tjerë: Endrit Zabërgja, GP-NISMA; Jehona Krasniqi, KDI dhe media.

Stafi mbështetës i Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i draft Strategjisë për bashkëpunim ndërkombëtar dhe marrëdhëniet ndërparlamentare;
3. Shqyrtimi i draft Raportit nga mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-095 për Diasporën dhe Mërgatën;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Kryetarja konstatoi se komisionit miratoi rendin e ditës.

2. Shqyrtimi i draft Strategjisë për bashkëpunim ndërkombëtar dhe marrëdhëniet ndërparlamentare;

Vjosa Osmani-Sadriu, njoftoi se dokumenti i titulluar “Strategjia për bashkëpunim ndërkombëtar dhe marrëdhëniet ndërparlamentare”, është përgatitur në vitin 2016, nga projekti i binjakëzimit, i financuar nga BE-ja, megjithatë kurrë nuk është azhurnuar me zhvillimet e reja dhe ka pas nevojë për ndryshime substanciale.

Ajo më tej njoftoi se përkundër faktit që komisioni ka angazhuar një ekspert, ai për arsye shëndetësore nuk ka arritur që të sjell dokumentin e rishikuar dhe se është dashur me stafin të bëhen ndryshimet e nevojshme, kryesisht teknike.

Kryetarja paraqiti vlerësimet e përgjithshme të dokumentit nga projekti i binjakëzimit si vijon: dokumenti është përgatitur shumë dobët; nuk ka ndonjë analizë të veçantë apo strategji që do të mund ta ndihmonte Kuvendin që të planifikojë ose koordinojë veprimet e tij në të ardhmen sa i përket fushës së politikës së jashtme; strategjia ka përmbytur copy-paste të dokumenteve të përgatitura nga BE-ja dhe institucionet e Kosovës, ka përmbytur copy-paste të kompetencave të institucioneve që merren me politikën e jashtme, janë përkrahur detyrat e Kryetarit të Kuvendit, të Kryesisë së Kuvendit, Komisionit të Jashtëm, Komisionit për Integritet Evropian, të MPJ-së, MIE-së etj.

Znj. Osmani, tha se ashtu siç është dorëzuar në komision, dokumenti është më shumë strategji për bashkëpunim ndërinstitucional, prandaj edhe që nga fillimi është vlerësuar se duhet të ndryshohet titulli, sepse për tu quajtur Strategji për bashkëpunim ndërkombëtar, duhet të përfshijë një analizë shumë më të hollësishme se si i qaset Kuvendi i Kosovës parlamenteve të tjera, si i qaset asambleve parlamentare të organizatave të ndryshme ndërkombëtare, cilat janë planet e parlamentit, apo cila është strategjia për tu anëtarësuar në organizata të tjera.

Kryetarja duke iu referuar dokumentit “Strategjia e Kuvendit për bashkëpunim ndërinstitucional në fushën e politikës së jashtme”, njoftoi për ndryshimet dhe plotësimet e bëra në këtë dokument.

Në arsyetimin që i dërgohet Kryesisë për këtë dokument propozohet që të jepet një vlerësim se dokumenti që i është proceduar komisionit ka qenë dokument jo i azhurnuar, nuk i ka përfshirë dokumentet e viti 2018 dhe se është dashur të bëhen ndryshime; në këtë arsyetim po ashtu të kërkohet nga Kryesia që ky dokument të konsiderohet dokument i gjallë.

Pasi që është kriter që duhet të plotësohet për zbatimin e MSA-së brenda këtij viti, kryetarja propozoi që të dërgohet me këtë përmbytje në Kryesi, të konstatohet se është kriter i plotësuar dhe në të njëjtën kohë Kryesia të konstatojë që Komisioni për Punë të Jashtme nga fillimi i vitit 2019, duhet të përgatisë strategji gjithëpërfshirëse të Kuvendit për fushën e politikës së jashtme.

Time Kadrijaj, falënderoi kryetaren e komisionit, e cila për një kohë të shkurtër e ka modifikuar dhe e ka sjellë këtë dokument në komision. Ajo tha se e përkrah këtë strategji dhe se është mirë që të miratohet, meqenëse ka hapësirë që në vitin 2019 të plotësohet dhe ndryshohet.

Elmi Reçica, tha se në mbledhjen e kaluar komisioni ka diskutuar për këtë çështje dhe se dokumenti i paraqitur është reflektim i atij diskutimi.

Pajtohet që dokumenti të procedohet Kryesisë për miratim si dhe me propozimin e kryetares për të shtuar stafin e komisionit, pasi që komisionit i janë shtuar edhe çështje tjera për trajtim. Ai tha se Drejtoria për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Protokoll, duhet të ndahet në dy drejtori sepse Kuvendi ka nevojë që të ketë një drejtori sa i përket marrëdhënieve ndërkombëtare, kurse çështja e protokollit është çështje tjetër. Në këtë drejtim, Reçica tha se ne duhet të kërkojmë që për vitin 2019, të parashihen mjete për këto aktivitete.

Reçica propozoi që komisioni të hartojë një strategji në të cilën përcaktohet çështja e vizitave dhe shprehu mendimin se është më mirë që komisioni të zhvillojë vizita më të shpeshta në ekipe më të vogla.

Sa i përket strategjisë, ai tha se e mbështetë strategjinë dhe se pajtohet që të shkojë si dokument dhe pastaj të vazhdohet trajtimi.

Vjosa Osmani-Sadriu, njoftoi se dokumenti që ka ardhur nga Projekti i Binjakëzimit, ka qenë dokument joserioz, mirëpo, me ndërhyrjet e nevojshme, tashmë besoj që ka marr formën e një dokumenti që e meriton përkrahjen. Ajo shtoi se këtij dokumenti i mungojnë planet strategjike me vendet e veçanta, si dhe një strategji më e hollësishme në raport me organizatat ndërkombëtare.

Sa i përket vizitave ajo njoftoi se komisioni do ta ketë një takim të fundvitit, ku do të diskutohet për të gjitha aktivitetet e këtij viti dhe planifikimi për vitin e ardhshëm, ndërsa propozoi që komisioni të dakordohet që të vizitohen 5 apo 6 shtete, që janë më me prioritet, kurse vizitat tjera varen nga zhvillimet ad-hoc.

Elmi Reçica, propozoi që komisioni ta ketë edhe një plan për atë se kush të ftohet për vizitë në Kosovë, pasi që është më efektive nëse vjen dikush në Kosovë dhe të njihet me realitetin, pasi që ka mungesë të informacioneve për Kosovën.

Vjosa Osmani-Sadriu, tha se pajtohet me propozimin e deputetit Reçica. Ajo më tej njoftoi se dokumenti që ka ardhur nga Projekti i Binjakëzimit i ka përfshirë disa shtojca, propozim marrëveshje që rregullojnë bashkëpunimin në mes të komisionit dhe MPJ-së, të cilat janë fshirë, pasi që Kushtetuta parasheh këtë lloj bashkëpunimi si dhe obligon Qeverinë të raportojë në Kuvend.

Kryetarja e komisionit pas diskutimeve konstatoi se Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Miratohet Strategjia e Kuvendit për bashkëpunim ndërinstitucional në fushën e politikës së jashtme dhe i procedohet Kryesisë së Kuvendit për miratim.

3. Shqyrtimi i draft Raportit nga mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-095 për Diasporën dhe Mërgatën;

Evgjeni Thaçi-Dragusha, njoftoi se komisioni, bazuar në Rregulloren e Kuvendit ka formuar grupin punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Diasporën si dhe për përbërjen e tij.

Ajo, po ashtu, njoftoi se gjatë kohës së mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit, grupi punues ka mbajtur disa takime që kanë pas për qëllim koordinimin, planifikimin dhe finalizimin e aktiviteteve të tij. Në bazë të të gjeturave, grupi i punës ka vlerësuar se cili është niveli i zbatimit të ligjit, ka konstatuar të arriturat dhe ka identifikuar problemet bazike që paraqiten gjatë zbatimit të tij dhe ka propozuar masa konkrete që duhet të ndërmerren për të ndryshuar gjendjen ekzistuese.

Thaçi- Dragusha, paraqiti raportin dhe rekomandimet e nxjerra nga mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit dhe propozoi që pika 10 e rekomandimit të bartet si pikë e parë.

Vjosa Osmani-Sadriu, tha se pajtohet me propozimin e deputetes Thaçi- Dragusha. Tek rekomandimi 4, ajo propozoi që në fund të tij, të shtohet teksti: “në këtë drejtim të ndryshohet Ligji për zgjedhjet e përgjithshme, për të avancuar të drejtat në votim të diasporës”. Në fund të rekomandimit 3, propozoi që të shtohet teksti: “këto ndryshime duhet të reflektohen edhe në Ligjin për investime strategjike”.

Glauk Konjufca, theksoi se fillimisht jemi në shpërputhje me atë që është planifikuar më herët nga ministria. Lidhur me ligjin në fjalë, theksoi që të bëhet propozimi për ndryshim të Ligjit për zgjedhje.

Vjosa Osmani-Sadriu, tha se në aspektin juridik, ne kemi të drejtë të propozojmë ndryshime të ligjeve ekzistuese, deri në momentin kur ato vinë zyrtarisht në Kuvend. Raporti me rekomandime nga mbikëqyrja e zbatimit të ligjit, propozoi që të mos procedohet për seancë, por të mbetet në arkivin e komisionit për nevoja të amendamentimit të P/ligjit i cili gjendet në procedurë, ndërsa njoftoi se me Ligjin për zgjedhjet, merret Komisioni për Legjislacion, i cili ka formuar një grup punues, ku nga komisioni ynë merr pjesë deputetja Maloku e po ashtu edhe organizata “Germin”, të cilët janë pajtuar për këto ndryshime.

Fitore Pacolli, në lidhje me rekomandimin 9, tha se nëse ne i propozojmë MDIS-së që të hapë një kanal, atëherë do të jetë në kundërshtim me kërkesën e diasporës, sepse ata kanë kërkuar që të respektohet formula, e cila ekziston në ligjin aktual.

Elmi Reçica, tha se mbikëqyrja e zbatimit të ligjit, është e rëndësishme, prandaj këtë raport me rekomandime propozoi që ta miratojë Komisioni. Ai njëkohësisht propozoi që rekomandimi 10 të renditet si rekomandim i parë, e më pas të vijë rekomandimet e tjera. Sa i përket informimit të diasporës përmes mjeteve tona të informimit, MDIS-ja, tha se ka shkuar një hap përpara me marrëveshjen e bërë me Shqipërinë.

Doruntinë Maloku-Kastrati, tha se nuk duhet lejuar që në çfarëdo forme të krijohet hapësirë për themelimin e një kanali të RTK-së për diasporën. Ajo propozoi që diaspora të ketë një program 100% në njërin prej kanaleve ekzistuese të RTK-së dhe se kjo të rregullohet me ligjin për RTK-në, por të mos themelohet kanal i ri. Ajo propozoi që rekomandimi 9 të jetë: MDIS në ligjin e ri të parasheh një program tërësisht dedikuar diasporës në njërin nga kanalet ekzistuese të televizionit publik.

Glauk Konjufca, në lidhje me skemën programore prej 6-9% e cila nuk po sigurohet për program enkas për diasporën, tha se në dëgjimet publike ka dëgjuar se gazetarët e RTK-së kanë kërkuar të holla të veçanta për t’i mbuluar ngjarjet e caktuara apo ndonjë aktivitet. Këtë duhet ta adresojnë institucionet tona si dhe Komisioni parlamentar për media, i cili duhet të vijë deri tek përfundimi se ku janë ngecjet në zbatimin e këtij ligji dhe ku janë problemet objektive, të cilat duhet të eliminohen.

Fitore Pacolli, propozoi që të mos parashihet program i veçantë për diasporën, sepse në një farë mënyre rrezikon ndarjen e diasporës në një kanal. Ajo propozoi që RTK-ja të respektojë hapësirën që e ka të obligueshme sipas ligjit 6-9% të skemës programore për diasporën dhe mos të ndahet diaspora me program të veçantë.

Doruntinë Maloku-Kastrati, theksoi se një delegacion i diasporës i cili është takuar me përfaqësues të partive politike, i kanë paraqitur nevojat e tyre që i kanë në emër të gjithë komunitetit shqiptar që jeton nëpër botë. Njëra nga këto kërkesa, tha se ka qenë parashikimi i një anëtari në Bordin e RTK-së dhe hapjen e një programi të veçantë për diasporën.

Fitore Pacolli, njoftoi se në takim me një përfaqësues të Këshillit në Suedi, ata kërkuar një hapësirë ku i menaxhojnë edhe financat, edhe programin e jo të gjitha të bëhen prej RTK-së, ndërsa diaspora të ketë vetëm një anëtar të bordit.

Doruntinë Maloku- Kastrati, theksoi se është kundër që diaspora të këtë një anëtar të Bordit në RTK, ngase është e padobishme. Që të përfaqësohet diaspora në RTK, më së miri do të ishte që dy përfaqësues të dy shteteve, me rotacion, çdo dy vite të jenë këshilltarë të jashtëm të drejtorit të përgjithshëm të RTK-së.

Glauk Konjufca, theksoi se është skeptik që prodhimi i programit 24 orë nga diaspora për vetveten do ta ketë kualitetin mediatik të atij programi, ngase atje nuk ka ndonjë shoqatë e centralizuar, e organizuar si RTK-ja, që mund mbulojë gjithë diasporën.

Doruntinë Maloku-Kastrati, theksoi se nuk e dinë se çfarë përmban marrëveshja me Shqipërinë, në lidhje me mbulimin televiziv, përderisa për programin që transmetohet në satelit, tha se nuk është as 20% i njëjtë me programin që transmetohet në Kosovë, ngase ai program që shkon përmes satelitit ka të drejta të rezervuara.

Vjosa Osmani-Sadriu, propozoi që të rekomandohet shqyrtimi i mundësisë së krijimit të një programi për diasporën dhe se në projektligjin e ri të jemi të kujdesshëm, lidhur me të gjitha çështjet të cilat u diskutuan. Ajo kërkoi që nga MDIS-ja t'i përcillen komisionit të gjitha marrëveshjet e arritura në mes të Kosovës dhe Shqipërisë.

Fitore Pacolli, theksoi se ne duhet të kërkojmë nga MDIS-ja që të angazhohet përderisa është ligji në fuqi, të respektohet skema programore 6-9% e hapësirës për diasporën, pasi që nuk është shumë afër që të bëhet programi i veçantë për diasporën. Rekomandimet lidhur me këtë çështje, tha se duhet t'i adresojmë në Ligjin e ri për diasporën.

Danush Ademi, kërkoi të informohet se si e kanë të rregulluar këtë çështje vendet e rajonit dhe se a kanë programe të veçanta për diasporën.

Vjosa Osmani- Sadriu, tha se ne duhet të kërkojmë nga Komisioni Parlamentar për Media, se çfarë analize kanë bërë ata deri më tani, për atë se si e kanë të rregulluar vendet e rajonit çështjen e skemës programore për diasporën. Ideja lidhur me programin televiziv ka qenë sipas njoftimit nga ministri, që kjo të bëhet bashkë me Shqipërinë.

Time Kadrijaj, theksoi se të gjitha këto çështje mund të rregullohen me draftin e ri, i cili pritet të procedohet në Kuvend. Kadrijaj propozoi që komisioni të miratojë raportin me rekomandime nga mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji dhe i njëjti të mbetet dokumentacion, në arkivin e Komisionit.

Glauk Konjufca, propozoi që në rekomandim të parashihet që MDIS-ja të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që arsimit në diasporë të organizohet dhe financohet në tërësi nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Vjosa Osmani-Sadriu, dha në votim propozimin për miratimin e raportit me rekomandime nga mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Diasporën dhe Mërgatën, me propozimet e anëtarëve të Komisionit, që në pikën 3 të rekomandimit të përfshihet reflektimi edhe në Ligjin për investimet strategjike; në pikën 4 të rekomandimit, që të ndryshohet Ligji për zgjedhjet e përgjithshme; në pikën 9, të përfshihet propozimi i deputetes Doruntinë Maloku- Kastrati; të plotësohet rekomandimi, sa i përket financimit të mësimin plotësues në diasporë, sipas propozimit të deputetit Glauk Konjufca si dhe pika 10, të radhitet si pika 1 e rekomandimeve.

Kryetarja e komisionit pas diskutimeve konstatoi se komisioni nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet raporti me rekomandime nga mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit 04/L-095 për Diasporën dhe Mërgatën, me plotësimet e anëtarëve të Komisionit.*
- 2. Raporti me rekomandime nga mbikëqyrja e këtij ligji, nuk procedohet për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare, meqë projektligji i ri është në procedurë e sipër t'i përcillet komisionit për shqyrtim.*
- 3. Raporti me rekomandime nga mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Diasporën dhe Mërgatën, mbetet dokumentacion i komisionit dhe i njëjti mund të përdoret me rastin e amendamentimit të projektligjit të ri, i cili së shpejti pritet të procedohet për shqyrtim në Kuvend.*

4. Të ndryshme

Vjosa Osmani Sadriu, njoftoi se më 19.12.2018, në orën 13:00, do të raportojë në Komision, ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme z. Behgjet Pacolli.

Ajo njëkohësisht njoftoi anëtarët e komisionit se u është shpërndarë një dokument i përgatitur nga KDI-ja në lidhje me Projektbuxhetin për vitin 2019, për të cilin tha se nëse ka nevojë mund të shqyrtohet në ndonjërin nga mbledhjet e Komisionit.

Znj. Osmani kërkoi mbështetjen nga përfaqësuesja e KDI-së e pranishme në mbledhje, që të ndihmojë në përpilimin e një amendamenti, përmes të cilit në buxhetin e Kuvendit, për KPJDIS-në, të kërkohen edhe dy pozita të reja për një këshilltar apo zyrtar për politikë të jashtme dhe një për diasporë dhe investime strategjike.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

Kryetarja e Komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.